


20.02.2017
of 254



Universiteti i Prizrenit University of Prizren Univerziteti Prizrena "UKSHIN HOTI"	
Pranuar me dt. 20.03.2017	
Zyra e pranimit	Nr. i protokolit
308	01-49/A



UNIVERSITETI
UNIVERSITY
UNIVERZITET
"HAXHI ZEKU"



Në bazë të Ligjit nr. 04/L-037/2011 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, nenit 49, pika 1.3 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit "Kadri Zeka" në Gjilan; nenit 48, pika 1.9 të Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren dhe nenit 48, pika 1.8 të Statutit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë (në tekstin e mëtejshëm: universitetet partnere).

Senati i Universitetit "Kadri Zeka" Gjilan, në mbledhjen e mbajtur më 16/02/2017; Senati i Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren në mbledhjen e mbajtur më 20/03/2017 dhe Senati i Universitetit "Haxhi Zeka" Pejë, në mbledhjen e mbajtur më 17/01/2017 miratuan përkatësisht këtë:

RREGULLORE NR. 01/2017 PËR PROGRAMIN MASTER QEVERISJA LOKALE DHE SHOQËRIA DEMOKRATIKE

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

1. Kjo rregullore përcakton kriteret unike të regjistrimit të studentëve në ciklin e studimeve të nivelit master (program i përbashkët i universiteteve partnere: Qeverisja Lokale dhe Shoqëria Demokratike), përgjegjësitë e partnerëve, kohëzgjatjen, organizimin dhe zhvillimin e studimeve, si dhe mënyrën e përfundimit të tyre.
2. Studimet masternë programin Qeverisja Lokale dhe Shoqëria Demokratike në universitetet partnere synojnë arsimimin profesional dhe kualifikimin shkencor të studentëve nëpërmjet integritit të procesit mësimor dhe kërkimeve shkencore.

Neni 2

Fushëveprimi

1. Kjo rregullore shtrin efektet e saj në fakultetet juridiketë universiteteve partnere, studentët dhe personelin e tyre.

Neni 3 Përkufizimet

1. **Program i përbashkët:** i referohet bashkëpunimi ndërmjet universiteteve partnere.
2. **Diplomë e përbashkët:** nënkupton një diplomë të përbashkët nga universitetet partnere në përputhje me Konventën e Lisbonës.
3. **Universiteti pritës:** universiteti ku zhvillohet mësim për semestër.
4. **Bartësit e programit:** profesorët përgjegjës nga universitetet partnere.

II. DISPOZITAT E VEÇANTA

Neni 4 Organizimi i studimeve

1. Këto studime organizohen dhe mbahen nga njësitë akademike të universiteteve partnere, sipas planprogramit mësimor të propozuar nga këshillat e fakulteteve përkatëse, të miratuar nga senatet e universiteteve partnere dhe të akredituar nga Agjencia e Kosovës për Akreditim.
2. Planprogrami mësimor, mund të ndryshohet apo të plotësohet sipas propozimit të këshillave të fakulteteve përkatëse të universiteteve partnere dhe i cili miratohet nga senatet e universiteteve Partneresi dhe Agjencia e Kosovës për Akreditim.
3. Në të gjitha fakultetet e universiteteve partnere, mësimi realizohet përmes ligjëratave, ushtrimeve teorike, mësimit praktik, seminareve, kolokuiumeve, konsultimeve profesionale, punimeve të pavarura të studentëve, si dhe ekskursioneve me karakter mësimor – shkencor.

Neni 5 Objektivat e programit

1. Objektivat kryesore të programit janë:
 - 1.1. Rritja e profilit institucional;
 - 1.2. Zgjerimi i ofertave arsimore;
 - 1.3. Nxitja e mobilitetit të studentëve dhe personelit;
 - 1.4. Avancimi i ekspertizës në fushën e arsimit, sigurimit të cilësisë, dhe internacionalizimin;
 - 1.5. Rritja e punësimit të diplomuarve.

Neni 6 Përgjegjësitë e universiteteve partnere

1. Secili nga universitetet partnere rekruton parimisht 1/3 e stafit akademik për mësimdhënie, mirëpo duke pasur parasysh profilit specifik, mund të angazhohen edhe profesorë të tjerë që nuk janë pjesë e stafit akademik të universiteteve partnere.

2. Stafi akademikë nga universitetet partnere propozohet konform dispozitave ligjore të tri universiteteve partnere.

Neni 7

Financimi i programit dhe pagat për stafin akademik

1. Universitetet partnere mbulojnë shpenzimet në mënyrë proporcionale. Shpenzimet ndahen në tri pjesë të barabarta dhe secili nga universitetet partnere obligohet të paguajë pjesën e tij të ndarë në mënyrë proporcionale.
2. Universitetet partnere inkurajohen të sigurojnë burimeve alternative të financimit përmes projekteve të mundshme.
3. Pagesa e mësimdhënësve do të realizohen si më poshtë:
 - 3.1. Pagesat e mësimdhënësve të rregullt bëhen nga vija buxhetore e universitetit përkatës, secili universitet i paguan mësimdhënësit e vet;
 - 3.2. Pagesat për mësimdhënësit e angazhuar bëhen në mënyrë proporcionale nga universitetet partnere, sipas semestrave ku mbahen ligjëratat;
 - 3.3. Të gjitha angazhimet në kuadër të programit të përbashkët do të paguheshin shtesë, pavarësisht normave dhe mbinormave të përcaktuara me rregulloret përkatëse të universiteteve partnere.

Neni 8

Organizimi i provimit pranues dhe regjistrimi e studentëve

1. Provimi pranues organizohet në secilin nga universitetet partnere ose me ndonjë marrëveshje organizohet nga njëri prej tyre.
2. Regjistrimi i kandidatëve do të bëhet në secilin nga universitetet partnere.
3. Përzgjedhja e studentëve do të bëhet duke u bazuar në kriteret e pranimit të përcaktuara me konkurs.
4. Studentet duhet të jenë të regjistruar si studentë të rregullt, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga konkursi i përbashkët i universiteteve partnere.
5. Studentët e regjistruar në këtë program studimi kanë të drejta, detyrime dhe përgjegjësitë njëjta me studentët tjerë të rregullt të universiteteve partnere.

Neni 9

Kreditë e programit dhe organizimi i ligjëratave

1. Programi i studimeve përbehet nga 120 ECTS dhe ligjëratat mbahen me rotacion, secili universitet organizon nga një semestër:
 - 1.1. Semestri i parë organizohet nga Universiteti "Kadri Zeka" në Gjilan;
 - 1.2. Semestri i dytë organizohet nga Universiteti "Ukshin Hoti" në Prizren;
 - 1.3. Semestri i tretë organizohet nga Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë;

- 1.4. Semestri i katërt përfshin punimin e diplomës dhe mbahet aty ku studenti zgjedh mentorin e punimit të diplomës.
2. Universitetet partnere me marrëveshje mund të vendosin të organizojnë procesin mësimor edhe në forma të tjera, konform dispozitave logjore për studime master.

Neni 10

Sigurimi i cilësisë së studimeve

1. Sigurimi i cilësisë së studimeve i nënshtrohet kriterëve të përcaktuara nga Ligji për Arsim të Lartë i Republikës së Kosovës.
2. Të gjitha të dhënat e studentëve ruhen në një bazë të të dhënave, forma dhe funksioni i së cilës rregullohet me marrëveshje mes universiteteve partnere.
3. Përgjegjës për sigurimin e cilësisë janë bartësit e programit dhe zyrtaret për sigurimin e Cilësisë në universitetet Ppartnere.

Neni 11

Diploma dhe shtojca e diplomës

1. Forma dhe mënyra e lëshimit të diplomës është unikeduke figuruar emërtimi i përbashkët i universiteteve partnere dhe fakulteteve përkatëse të tyre, si dhe duke u nënshkruar nga tre rektorët dhe dekanët e fakulteteve përkatëse.
2. Një shtesë e diplomës lëshohet së bashku me diplomën që do të ndjekë një standard të vendosur nga autoriteti i cilësisë dhe përmbajtjen sipas marrëveshjes së universiteteve partnere.

Neni 12

Bartësit e programit

1. Bartësit e programit përcaktohen nga universitetet partnere nga njësitë akademike përkatëse të tyre.
2. Me marrëveshje mes universiteteve partnere, njëri nga tre përfaqësuesit e universiteteve partnere përcaktohet bartës i parë i programit dhe përgjegjës për të gjitha çështjet e lidhura me të.

Neni 13

Partneriteti mes universiteteve

1. Partneriteti mes universiteteve partenere konfirmohet me miratimin e kësaj rregulloreje, e cila nënkupton që:
 - 1.1. Partneriteti është i obligueshëm për tri gjenerata, respektivisht për katër vite akademike;
 - 1.2. Largimi nga programi i ndonjërit nga universitetet partnere duhet të paralajmërohet një vit më parë;

1.3. Trashëgimia i takon universitetit partner që nuk largohet nga programi.

Neni 14

Mentorimi i punimit të diplomës

Mentorimi i studentëve gjatë punimit të diplomës do të bëhet sipas përzgjedhjes së studentëve.

Neni 15

Çështjet administrative

Çështjet administrative në vitin e parë i kryen Universiteti "Kadri Zeka" në Gjilan. Në vitet vijuese partneret vendosin me marrëveshje.

III. DISPOZITAT KALIMTARE

Neni 16

Për të gjitha çështjet që eventualisht nuk janë adresuar në mënyre specifike në këtë rregullore, vlejné dispozitat ligjore sipas Ligjit për Arsim të Lartë, statuteve dhe rregulloret relevantetë universiteteve partnere.

Neni 17

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve mes universiteteve partnere

Në rast mosmarrëveshje, universitetet partnere fillimisht duhet të gjejné zgjidhje adekuate përmes marrëveshjes me tyre. Në të kundërtën, gjykata kompetentëdo të bëjë zgjidhjen e kësaj mosmarrëveshjeve.

Neni 18

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi në datën e miratimit të saj nga senatet e universiteteve partnere dhe nënshkrimit të saj nga rektorët përkatës.


Rektori i UKZ-së
Gjilan, më 06.02.2017


Rektori i UUH-së
Prizren, më 06.02.2017


Rektori i UHZ-së
Pejë, më 06.02.2017